



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

Komuna e Kaçanikut

Opština Kačanik/ Municipality of Kačanik

Kuvendi i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	04.09.2026	Vendi	Kaçanik
Nj. org.	Numri	01-060/01-24190/26	Shtojce	

NJOFTIM PUBLIK

FTESË PËR DËGJIM PUBLIK BUXHETOR

**Lidhur me Propozim-Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin 2027 dhe vlerësimet
buxhetore për vitet 2028–2029**

Të nderuar qytetarë të Komunës së Kaçanikut,

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, pas pranimit të Propozim-Buxhetit të Komunës së Kaçanikut për vitin 2027 dhe vlerësimeve buxhetore për vitet 2028-2029, ju fton të merrni pjesë në dëgjimin publik buxhetor, i cili organizohet në kuadër të procesit të shqyrtimit dhe miratimit të buxhetit komunal.

Dëgjimi publik organizohet me qëllim që qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile, përfaqësuesve të bizneseve, komuniteteve, grupeve të interesit dhe palëve të tjera të interesuara t'u mundësohet të njihen me Propozim-Buxhetin dhe të paraqesin komente, vërejtje, kërkesa dhe sugjerime para shqyrtimit dhe miratimit përfundimtar nga Kuvendi i Komunës.

Ky proces zhvillohet në bazë të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Statutit të Komunës së Kaçanikut dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Dëgjimi publik buxhetor do të mbahet sipas orarit në vijim:

Tema	Data	Ora	Vendi
Propozim-Buxheti i Komunës së Kaçanikut për vitin 2027 dhe vlerësimet buxhetore për vitet 2028–2029	18.09.2026 (e premte)	11:00	Salla e Kuvendit të Komunës

Propozim-Buxheti dhe materialet përcjellëse janë të publikuara në webfaqen zyrtare të Komunës së Kaçanikut, në rubrikën “Buxheti dhe Financat”:

<https://kacanik.rks-gov.net/buxheti-financat/>

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut fton të gjithë qytetarët dhe palët e interesuara që të marrin pjesë dhe të japin kontributin e tyre në këtë proces të rëndësishëm të planifikimit dhe vendimmarrjes buxhetore.

Mirëpresim pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj!

Kryesuesi i Kuvendit

Selajdin Troni

